

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare
Seanca nr.2003/25
Prishtinë,më 25 shtator 2003,në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit të Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Fatmir Sejdiu,anëtar i Kryesisë së Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Gojko Saviq,anëtar i Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 78 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Kuvendi në seancën e mëparshme e kishte miratuar këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë-nr.2003/25;dhe
3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për pesticidet-nr.2003/26.

Kryesuesi kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohet sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

Berat Luzha tha se në seancën e mëparshme u diskutua për situatën politike në Kosovë, me theks të veçantë për bisedimet e paralajmëruara me Serbinë, por debati u ndërpre pa e miratuar asnjë përfundim apo deklaratë. Ai në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, propozoi që Kuvendi ta miratojë një platformë politike e cila do t'ju shërbejë institucioneve kompetente për bisedime.

Kryesuesi tha se në njërin nga seancat e ardhshme, Kuvendi në propozim të grupeve parlamentare, do t'i miratojë përfundimet përkatëse lidhur me këtë çështje.

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme.

Gani Koci pati vërejtje se në transkript, në faqën 38, në evidencimin e diskutimit të tij të deponuar me shkrim, është bërë një lëshim me rastin e përshkrimit. Në pasusin e parë, në vend të “fjalës” duhet të jetë: “**fajet**” dhe në pasusin e tretë, në vend të “marrëveshjes publike”, duhet të jetë: “**marrëveshje politike**”.

Edi Shukriu kërkoi që të gjitha diskutimet e deputetëve, përveç në transkript, të përfshihen edhe në procesverbal.

Me këto vërejtje u miratua procesverbali i seancës së mëparshme.

2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë-nr.2003/25.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Financave dhe të Ekonomisë që ta arsyetonte këtë p/ligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Ali Sadriu- Ligji mbi menaxhimin e financave publike dhe të përgjegjësisë, konkretisht neni 44, kufizon huadhëniet, huamarrjet dhe kapitalizimet. Duke parë këtë, si komponentë kufizuese dhe duke u nisur nga fakti se në praktikë autoritetet publike po ballafaqohen me vështirësitë financiare, parashtrohet nevoja e shqyrtimit të mundësive për të lejuar hua nga ana e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, një autoriteti publik, nëse Qeveria dhe PSSP paraprakisht pajtohen me shumën, kushtet dhe qëllimin e asaj huaje. Praktika e deritanishme e mbështetjes së nevojave vijuese financiare të autoriteteve publike, në këtë rast kompanive publike por edhe të tjera, nga grantet e buxhetit duhet të mënjanohet. Në këtë kontekst jemi në vazhden e shqyrtimit të mundësive të gjetjes së zgjidhjeve të pranueshme për financimin e veprimtarive vijuese për zhvillimin e këtyre kompanive përmes mënyrave tjera.

Kjo mënyrë e përkrahjes po shqyrtohet për mbështetjen e KEK-ut si kompani publike, e cila domosdo, në një të ardhme të afërt duhet të ballafaqohet me procesin e ristrukturimit të përgjithshëm. Një fenomen i tillë do të obligonte KEK-un që të menaxhohen mjetet me

efikasitet më të lartë se gjertani, kurse, nga ana tjetër, paraprakisht, do të obligohej për kthimin e atyre mjeteve.

Kjo formë e plasimit të mjeteve do të mund të përdorej edhe në rastet tjera të ngjashme për financimin e projekteve të ndryshme zhvillimore kur konstatohet se nuk ka zgjidhje tjetër të mundshme në kuadër të tregut financiar. Kjo do të mund të aplikohet për “Trepçën” apo edhe për rastet tjera kur është e domosdoshme mbështetja financiare, me tendencë që financimet nga grantet buxhetore të evitohen.

Në bazë të kësaj, propozoj amendamentin, i cili ndryshon Ligjin nr. 2 të vitit 203 – Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësisë, përkatësisht nenin 44 të këtij Ligji, duke ia shtuar paragrafin 4. Citoj: “Neni 44.4-Pavarësisht nga dispozitat tjera të nenit 44,Ministria e Ekonomisë dhe Financave mund t’i japë hua një autoriteti publik, nëse Qeveria dhe PSSP paraprakisht pajtohen me shumën, kushtet dhe qëllimin e asaj huaje.

Shpagimi i huasë dhe mjetet nga interesi për këtë huadhënie do të derdhen në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës”.

Në fund,ministri Sadriu i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Opinionet,vëretjtet dhe sugjerimet lidhur me këtë p/ligj i dhanë deputetët:Haki Shatri,Bajrush Xhemajli,Dragisha Krstoviq,Bajram Kosumi,Oliver Ivanoviq,Ramadan Kelmendi,Sadik Idrizi,Milovan Ivanoviq dhe Muhamed Kelmendi që i janë bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----2;

Abstenime----7.

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miratoi,në parim,P/ligjin më ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.Kuvendi e ngarkoi Komisionin për financa dhe ekonomi,Komisionin për buxhet dhe Komisionin për çështje gjyqësore,legjislacion dhe Korinzë Kushtetuese që ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t’ia paraqesin Kuvendit, raportet me rekomandime për miratim.

3. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për pesticidet-nr.2003/26.

Kryesuesi e ftoi ministrin e Bujqësisë,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që ta arsyetonte këtë p/ligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri Goran Bogdanoviq- Nevoja për nxjerrjen e këtij p/ligji ka të bëjë më faktin se në Kosovë,çështja e pesticideve nuk ka qenë e rregulluar me ndonjë ligj të veçantë.Duke pasur parasysh faktin se në Kosovë,po importohet gjithëçka,posaçërisht në fushën e farëname dhe të mjeteve mbrojtëse,kjo ministri,ka marrë për obligim hartimin e këtij

p/ligji.Me këtë p/ligj synohet t'ju ndihmohet bujqëve individual në zgjidhjen e çështjes sëpesticideve dhe të kemikaleve,që përdoren në prodhimtaritë bujqësore.

Çështjet kryesore që i normon ky p/ligj janë:Regjistrimi i pesticideve,leja për prodhimin,tregtimin dhe shpërndarjen e tyre;Pesticidet që janë të ndaluara dhe rrepësisht të kufizuara ato që janë të rrezikshme për shëndetin e njeriut.Vetëmpesticidet e regjistruara mund të prodhohen dhe të lëshohen në qarkullim dhe me këtë vepërimtari mund të merren ata persona që janë të pajisur me certifikat për prodhimin,tregtimin dhe shpërndarjen e tyre.

Me këtë p/ligj janë të ndaluara dhe rreptësisht të kufizuara prodhimi i pesticideve dhe kemikaleve të rrezikshme ,që shkaktojnë dëme shëndetësore dhe ekologjike.

Autoriteti kompetent për regjistrimin e pesticideve dhe licencimin e personave që merren me prodhimin dhe tregtimin e tyre, është në kuadër të kësaj ministrie.

Për zbatimin e këtij p/ligji,kompetent është inspektorati,i cili mund të inspektojë çdo tokë punuese,çdo objekt,çdo automjet transportues që llogariten të dyshimta sipas dispozitave të këtij p/ligji.

Në fund,ministri Bogdanoviq i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratonin këtë p/ligj.

Opinionet,vërejtjet dhe sugjerimet lidhur me këtë p/ligj i dhanë deputetët:Jusuf Sutaj,Berat Luzha,Dragisha Krstoviq,Sebahate Grajçevci,Hilmo Kandiç,Blerim Baruti dhe Ibush Jonuzi që i janq bashkangjitur transkriptit.

Kryesuesi e vuri në votim këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----të gjithë;

Kundër-----0.

Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi:Kuvendi i Kosovës e miartoi,në parim,P/ligjin për pesticidet dhe e ngarkoi Komisionin për bujqësi,pylltari dhe zhvillim rural,Komisionin për çështje gjyqësore,legjislacion dhe Kornizë kushtetuese dhe Komisionin për buxhet që ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

Seanca përfundoi në orën 11:30 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

akademik **Nexhat DACI**

